



# BULETINI MUJOR

KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM

**Kryetari Ahmeti organizoi ceremoninë solemne tradicionale me rastin e festave të fundvitit**





# Kryetari Ahmeti ka mbajtur takim publik me qytetarë

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti në sallën e Kuvendit Komunal në përmbyllje të vitit 2021, ka mbajtur mbledhjen publik me qytetarë, të cilët i ka njoftuar për punën njëvjeçare të qeverisjes lokale dhe ka diskutuar për projektet, sfidat dhe të arriturat e komunës në vitin që po e lëmë pas.



# **Diamant Bytyqi emërohet Nënkryetar i Komunës së Lipjanit**

**Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ka emëruar Diamant Bytyqi Nënkryetar të Komunës së Lipjanit.**

**Po ashtu, gjatë ditës në mbledhjen e dytë të Kuvendit të Komunës së Lipjanit me shumicë votash Lulzim Qerimi është emëruar Nënkryetar i Komunës për Komunitete**





# Kryetari Imri Ahmeti priti në takim shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë, Michael Davenport

Kryetari i Komunës, Imri Ahmet, ka pritur në takim shefin e misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, ambasadorin Michael Davenport, me ç'rast kanë biseduar lidhur me bashkëpunimin e deritanishëm që misioni i OSBE-së ka pasur me Komunën e Lipjanit.





# Po vazhdon proesi i vaksinimit anti COVID-19 në shkollat e Lipjanit

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale Merita Bytyqi së bashku me Drejtoreshen e Arsimit në Lipjan Elmaze Behluli, gjatë ditës vizituan Shkollën fillore "17 Shkurti" në Glllogovc për të parë për së afërmi procesin e vaksinimit anti COVID-19 tek nxënësit e kësaj shkolle.





# Kryetari Ahmeti ka pritur komandantin e KFOR-it amerikan nga Bondsteel në Kosovë Colonel Brey Hoppkins

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, në zyrën e tij ka pritur, komandantin e KFOR-it, amerikan nga Bondsteel në Kosovë Colonel Brey Hoppkins me bashkëpunëtorë të shoqëruar edhe nga përfaqësuesit e KFOR-it Turk të cilët janë të vendosur në Lipjan.





**Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ka pritur në takim përfaqësuesit e Organizatës YAHR ku gjatë takimit u bisedua për aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2021 dhe të cilat planifikohen të zhvillohen në vitin 2022.**

**YAHR falënderoi kryetarin Ahmeti i cili shprehi gatishmëri që ti përkrah të rinjtë në aktivitetet të cilat do të zhvillohen në vitin e ardhshëm.**





**Një delegacion i Komunës së Lipjanit me rastin e 23 vjetorit të rënies së dëshmorëve të fshatit Krojmir, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora me lule pranë pllakes përkujtimore së katër dëshmorëve në Krojmir**





# **Komuna e Lipjanit ka ndezur dritat dhe pemën dekorative për festat e fundvitit**

**Në praninë e shumë qytetarëve e në përqafimin e shumë fëmijëve, Kryetari i Komunës Imri Ahmeti ka ftuar fëmijët prezent për ti ndezur bashkërisht dritat dekorative për festat e fundvitit.**





# **Përmbyllen aktivitetet në 16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore**

**Këshilli Komunal Koordinues në Mbrojtje të Viktimave të Dhunës në Baza Gjinore me qëllim të sensibilizimit kundër dhunës, pas 16 diteve të aktivizimit kunder dhunes ne familje ka përmbyllur aktivitetet. Ku u fillua me marshin në qytetin e Lipjanit e pastaj për të vazhduar me sesione këshilluese në shkolla të mesme dhe fillore të qytetit dhe fshatrave të Lipjanit, po ashtu janë mbajtur sesione këshilluese edhe në qendren korrektuese edukuese QKL- Lipjan, si dhe me anëtarët gra nga Bashkësia Islame- Departamenti i gruas.**





**Biblioteka e qytetit në Lipjan në fondin librar është pasuruar me 116 tituj dhe 753 ekzemplar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka bërë të ditur drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport Anila Reqica - Llugiqi.**

**Ajo po ashtu ka theksuar se po kontribuojmë qdo ditë e më shumë në shtimin e sa më shumë titujve të rinjë me synim të nxitjes së lexuesve lipjanas dhe motivimit të tyre për të qenë sa ma afër librit**





# Mbahet aktiviteti në kuadër të fushatës 16 Ditët e Aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas

Fushata Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas 25 nëntor-10 dhjetor është aktiviteti i rëndësishëm ndërgjegjësues që synon forcimin e transparences nga të gjitha institucionet shtetërore dhe akterëve të tjerë në luftën kundër dhunës ndaj gruas.





**Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti së bashku me ambasadoren e Holandës në Kosovë Carin Lobbezoo dhe shefja e zyrës së Unicefit në Kosovë Nona Zicherman dhuruan 15 laptop për shkollat "Adem Gllavica" dhe "Vëllezërit Frashëri" kjo me financim nga ambasada e Holandës në Kosovë.**





**Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan në krye me Zaim Baftiun, kanë vizituar Kryetarin e Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti, të cilin e kanë uruar për mandatin e ri në krye të Komunës.**







# VAKSINOHU!



#Bashkëiadalim



Mbrëmje dimri në fshatin Blinajë!





**KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM**



# **BULETINI MUJOR**



**RR. SHQIPËRIA NR: 28 14000 LIPJAN, KOSOVË**

**TEL: 038 200 41 508**

**THIRR PA PAGESË 0 800 14 000**

**EMAIL: [INFOKOMUNA.LIPJAN@RKS-GOV.NET](mailto:INFOKOMUNA.LIPJAN@RKS-GOV.NET)**